



DATE: 17.10.2024

NR.09/ 8525 /2024

## KONTRATË PËR PUNË

Numri i kontratës:<sup>1</sup> 659-24-6828-5-3-6/C572 & KKHE-24-031-5-3-6

**KOMUNA HANI I ELEZIT**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

**Grup i Operatorëve Ekonomik DS Company SH.P.K.; BEREQETI - ING, Rr.Isa Boletini, Prishtine**, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

**Riparimi i rrugeve dhe trotuareve ne Han te Elezit dhe ne fshatrat (Paldenice, Seçishtë, Dimce, Rezhance, Krivenik)** me numër identifikues: 659-24-6828-5-3-6

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Riparimi i rrugeve dhe trotuareve ne Han te Elezit dhe ne fshatrat Paldenice, Seçishte, Dimce, Rezhance, Krivenik**

No.	Lot
1	Riparimi i rrugeve dhe trotuareve ne Han te Elezit dhe ne fshatrat (Paldenice, Seçishtë, Dimce, Rezhance, Krivenik)

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **9,971.70 €**; [Nëntmijë e nëntqind e shtatdhjetë e nje Euro /70 cent] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të fillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i fillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën 2 në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	17.10.2024
Vula:	

Për Kontraktuesin Grup i Operatorëve Ekonomik DS Company SH.P.K.; BEREQETI - ING

Emri:	Dituror Sadiku
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	17.10.2024
Vula:	

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-24-6828-5-3-6/C572

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Ferizaj dega ne Kaçanik
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>10% e vleres se kontrates me afat prej 4 muajve.</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: i. të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> ii. të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <i>[shëno numrin]</i> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është <i>[brenda afatit]</i> ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <i>[me ditën e nënshkrimit te kontrates]</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>[Brenda afati prej 90 ditve nga koha e fillimit te punimeve]</i> ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>[0.25%]</i> për ditë per pune te padorezuara Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <i>[10%]</i> e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<i>[Punet do te regjistrohen ne liber dhe ditae ndertimor].</i>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>[Amir Berisha –Zyrtar ne DSHPE].</i>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A EUR
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>[N/A Perveq sigurimi i kualitetit te punimeve me afat prej 12 muajve nga koha e prnimit te punimeve]</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>[shëno numrin]</i> ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është <i>12 Muaj nga koha e pranimit te projekti me garancion te kualitetit te punimeve]</i> ditë,
Pagesa pas shkëputjes	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që

së kontratës		përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është [shëno përqindjen].
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	[Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose permes procedurave alternative te zgjidhje se mosmarrveshjeve-procedurat e ndermjetesimit me pajtimin e te dy palve
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Ferizaj-dega ne Kaçanik] në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</p>